

Ekran helmetë

Udhëzuesi i fillimit



Përpara përdorimit, referojuni gjithashtu "Masat paraprake shëndetësore" dhe "Masat paraprake" në "Udhëzuesi i referencave".

HMZ-T3W



Printuar me bojë me bazë vegjetale pa VOC (përbërës organikë të ajrit).
© 2013 Sony Corporation
4-471-975-11(1) (AL)

1 Lidhja

Përgatitni artikujt e mëposhtëm të përfshirë në kuti.




Njësia helmetë dhe njësia e baterisë (1)




Njësia e përpunimit (1)




Kufjet (1)




Kabloja HDMI (1)



Kabloja mikro-USB (1)



Ushqyesi (i vogël) (AC-UD10) (1)




Ushqyesi (i madh) (AC-L200D) (1)

Kordoni elektrik (për rrjetin elektrik) (2)

Përpara përdorimit, karikoni baterinë.

Karikimi fillon kur ushqyesi i vogël dhe kordoni i rrymës lidhen me njësinë e baterisë.

Treguesi  (i rrymës) ndizet në ngjyrë portokalli gjatë karikimit, dhe fiket kur përfundon karikimi.



Këshilla

- Ju mund të përdorni sistemin gjatë karikimit, me kordonin e rrymës të lidhur me burimin e rrymës.
- Duhet rreth 5 orë që bateria të karikohet plotësisht, kur sistemi është i fikur.

1 Lidhni pajisjen e riprodhimit dhe një televizor me njësinë e përpunimit.

Ju mund të shikoni video nga pajisja e riprodhimit në televizor duke e lidhur televizorin me njësinë e përpunimit me një kablo HDMI të shpejtësisë së lartë. Në këtë rast, vendoseni "HDMI pass-through" te "General Setup" në "On".


Shënim

- Pasazhi HDMI nuk aktivizon riprodhimin njëherësh të videos në njësinë helmetë dhe në televizor.



2 Lidhni kufjet.


Lidhni mini-fishën e kufjeve me folenë e kufjeve.



3 Lidhni ushqyesin e madh dhe kordonin e rrymës AC me njësinë e përpunimit.



Njësia e përpunimit (prapa)




Ushqyesi (i madh) (jepet)

Kordoni elektrik (jepet)


Në prizë

4 Ndizni sistemin.

1. Ndizni njësinë e përpunimit.




2. Ndizni njësinë helmetë.



5 Ndizni pajisjen e riprodhimit.

6 Zgjidhni hyrjen.


Shtypni butonin INPUT në njësinë e përpunimit për të zgjedhur hyrjen për pajisjen burimore. Treguesi HDMI INPUT i hyrjes së zgjedhur do të ndizet në dritë portokalli.



7 Rregulloni orientimin e njësisë së baterisë dhe konfirmoni që treguesi WIRELESS të ndizet në ngjyrë blu.


Shënime

- Valët radio mund të mos kapen mirë, në varësi të orientimit të njësisë së baterisë. Përdorni njësinë e baterisë me anën e logos SONY lart.
- Përdoreni aty ku nuk ka pengesa mes njësisë së përpunimit dhe njësisë së baterisë.



2 Rregullimi dhe vendosja

Për një vendosje komode



- A** Njësia duhet të mbështetet mes ballit dhe dy pozicioneve në pjesën e pasme të kokës.
- B** Mos e vendosni peshën mbi hundë.
- C** Rregullojeni njësine në mënyrë që ekranet t'i keni përpara syve.
- D** Vendosni njësine e baterisë në një pozicion të qëndrueshëm.

Nëse mbani normalisht syze ose lente kontakti, mbajini ato si zakonisht (me përjashtim të syzeve të leximit). Vini re se shikimi me syze bifokale mund të mos jetë optimal.

1 Ngrieni shiritin e sipërm të kokës dhe mbështetësen e ballit.

Pozicioni i mbështetëses së ballit mund të rregullohet.
Pozicioni më i ulët është standard.

2 Tërhiqni shiritat e sipërm dhe të poshtëm të kokës.

Mbani shtypur butonin në anën e sipërme të secilit rregullues dhe tërhiqni shiritin në të djathtë.

3 Vendosni në kokë njësine helmetë.

Uleni shiritin e poshtëm të kokës në bazën e kokës.

4 Lironi shiritat e kokës dhe rregulloni pozicionin e njësisë helmetë.

Fusni shiritin në rregulluesin në shiritat e kokës lart dhe poshtë për të rregulluar njësine helmetë.
Rregulloni me kujdes njësine majtas, djathtas, lart dhe poshtë për të gjetur pozicionin më të mirë për të parë qendrat e ekraneve.



5 Shtrëngoni shiritat e kokës mirë.

6 Vendosni kufjet.


Kur vendosni syze ose ju nevojitet rregullim i mëtejshëm
Referojuni “Përshtatja e njësisë helmetë” te “Udhëzuesi i referencave”.

3 Konfigurimi dhe shikimi

Ndiqui udhëzimet e shfaqura në ekran për përdorimin.



Ekran




1 Zgjidhni një gjuhë për ekranin (vetëm herën e parë).

Shtypni butonin ▲/▼ për të përzgjedhur një gjuhë, dhe më pas shtypni butonin MENU ose butonin ►.



2 Rregullimi i hapësirës mes lenteve.



Rrëshqitni rregulluesin e hapësirës së secilës lente derisa t'i shikoni qartë të dy ekranet. Pas rregullimit, shtypni butonin MENU ose butonin ►.

Këshilla

- Nëse nuk arrini të shihni ekranin qartë pas rregullimit të hapësirës mes lenteve, filloni nga fillimi nga pjesa “2 Rregullimi dhe vendosja”.
- Nëse rregullimi është i vështirë, provoni të rrëshqisni të dy rregulluesit në pozicionin qendror përpara rregullimit.

3 Kontrolloni drejtvendosjen e pamjes.

Konfirmoni që të tre shenjat “T” dhe vija horizontale të ndërpriten, dhe më pas shtypni butonin MENU ose ►.

Është e pranueshme nëse shenjat “T” dhe vija horizontale kryqëzohen në një pozicion tjetër nga qendra e ekranit.

Shënim

- Shenjat “T” dhe vija horizontale nuk ndërpriten, nëse ndryshohet pozicioni i njësisë së montuar helmetë. Rregulloni sërish gjatësinë e shiritave të kokës dhe konfirmoni pozicionin, duke iu referuar “2 Rregullimi dhe vendosja” dhe “3 Rregullimi i hapësirës mes lenteve”.
- Nëse qoftë edhe një nga shenjat “T” dhe vija horizontale nuk kryqëzohen, referojuni “Konfirmimi i drejtvendosjes së ekraneve” te “Udhëzuesi i referencave”.

4 Ndiqui udhëzimet e shfaqura në ekranin e televizorit.

Për funksionimin referojuni informacionit që shfaqet në ekran.



5 Ndizni pajisjen e riprodhimit.

Figura shfaqet në ekranin e njësisë helmetë.

Këshilla

- Rregulloni volumn duke përdorur butonin VOL +/- në njësine helmetë.
- Është e mirë të mbahet pranë njësia e telekomandës për pajisjen e riprodhimit.
- Disa funksione të pajisjes së riprodhimit mund të kontrollohen nga sistemi. Për detaje referojuni “Control for HDMI” te “Konfigurimi i përgjithshëm” te “Udhëzuesi i referencave”.

Zgjidhja e mungesës së audios, videos ose riprodhimit në 3D



- Ndizni njësine e përpunimit dhe njësine helmetë.
- Fikni dhe më pas ndizni sërish pajisjen e riprodhimit.
Nëse pajisja e riprodhimit është PlayStation®3, fikni dhe më pas mbani shtypur butonin e ndezjes në PlayStation®3 për të paktën 5 sekonda (derisa të dëgjoni një tingull tjetër bip) për ta rindezur atë.

“PlayStation” është markë e regjistruar tregtare e Sony Computer Entertainment Inc.